

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN E KËSHILLIT TE MINISTRAVE
PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.933, DATË 29.12.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
ORGANIZATIVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS
MJEKËSORE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 147/2014, datë 30.10.2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, të Ligjit Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Projektvendimi ka për qëllim ndryshimin e VKM-së nr.933, datë 29.12.2014 “Për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së”, i ndryshuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është pjesë e programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2020.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektvendimi do të kontribuojë në mbulimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të urgjencës mjekësore, unifikimin dhe standartizimin e këtij shërbimi, si dhe kualifikimin e personelit që është pjesë e këtij shërbimi, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem të unifikuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të Ligjit Nr. 147/2014, datë 30.10.2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk ka përputhshmëri me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti ndryshon në pikat e mëposhtme VKM nr.933, datë 29.12.2014 “Për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së”.

Në pikën 1 shtohet numri i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. Në përbërje të QKUM-së kanë kaluar urgjencat paraspitalore të Spitalit Universitar të Traumës, Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Në pikën 2 numri total i punonjësve të QKUM-së, së bashku me urgjencat paraspitalore të Tiranës shkon 253 veta, që rrjedh nga totali i punonjësve të QKUM-së dhe urgjencave paraspitalore (pa ndryshim të numrit total).

Në pikën 3 përcaktohet se Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) ofron shërbim, komandim, kontroll dhe koordinim të shërbimit kombëtar të urgjencës mjekësore dhe se pjesë e QKUM-së do të jetë Njësia e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore, në përbërje të Drejtorisë së Koordinimit të Urgjencave.

Në projektvendim është shtuar pika 3/1 duke specifikuar krijimin e Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore si pjesë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe numri i punonjësve të saj pasqyrohet në strukturën organizative të QKUM-së. Asetet e strukturave të urgjencës mjekësore paraspitalore të tre spitaleve universitare të sipërpërmendura të Tiranës kalojnë në inventar të QKUM-së.

Në projektvendim është shtuar pika 3/2 duke specifikuar se QKUM bën trajnimin e personelit shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. QKUM bën trajnimin e personelit joshëndetësor (personel ndihmës, mbështetës, dhënës i ndihmës së parë etj) në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, publik dhe privat, institucione të ndryshme publike dhe private. Këto detyra të QKUM-së janë specifikuar në zbatim të ligjit nr.147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”.

Në pikën 4 të VKM-së së re përcaktohet se, përveç Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, edhe Njësia e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore janë operative 24 orë, për 7 ditë të javës, dhe koordinohen nga përgjegjësit e turneve, të cilët janë mjekë të këtyre njësive. Personeli mjekësor i QKUM-së, Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter shërben me rotacion në të gjitha këto njësi, për mbulimin e shërbimit. Ky parashikim është bërë për menaxhimin efikas dhe mbulimin e shërbimit në të gjitha llojet e ofrimit të tij, telefonatë, shërbim tokësor dhe ajror.

Në pikën 5 projektvendimit janë shtuar disa nga përgjegjësitë e QKUM-së:

Personeli mjekësor i QKUM-së, Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter zhvillon aktivitetin e tij pranë Urgjencave Spitalore, Qendrave Shëndetësore, institucioneve private etj, në rast se QKUM lidh marrëveshje me këto institucione. Ky parashikim është bërë me qëllim mbulimin e shërbimit të urgjencave dhe plotësimin e kualifikimit intra-extra spitalor të personelit.

QKUM lidh marrëveshje me Spitalet, Qendrat Shëndetësore, institucione private etj, për mbulimin e shërbimit me personel të vetin ose të Institucioneve të sipërpërmendura.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.933, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar”

Personeli mjekësor mbulon shërbimin brenda orarit të punës dhe me roje. Ky parashikim është bërë për të mbuluar shërbimin e urgjencës mjekësore në rast mungese të personelit shëndetësor.

QKUM krijon të ardhura dytësore, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme dhe trajnimeve, që do të përdoren për përmirësimin e cilësisë së shërbimit, plotësimin me pajisje dhe aparatura mjekësore, plotësimin e një qendre simulimi për trajnim, kualifikim e specializuar personeli etj.

Është specifikuar që QKUM bën çertifikimin e personelit shëndetësor dhe joshëndetësor që kryen aktivitetin në Shërbimin e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore publike dhe private, si dhe çertifikimin e personelit joshëndetësor që kryen aktivitetin në shërbimin shëndetësor, publik dhe privat, në Republikën e Shqipërisë.

Strukturat e urgjencave mjekësore paraspitalore të tre spitaleve universitare kalojnë në administrim te Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, së bashku me asetet dhe burimet financiare të planifikuara për këtë shërbim në buxhetin e vitit 2020.

Në lidhjen nr.1 bashkëlidhur projektvendimit, numrit total të punonjësve të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore i është shtuar numri i punonjësve të urgjencës mjekësore paraspitalore të 3 spitaleve universitare (SUT, SUSHN, QSUT). Numri total i punonjësve nuk ndryshon. Është bërë riorganizimi i sektorëve brenda drejtorive përkatëse të QKUM-së.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dërgohet për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Departamentin e Administratës Publike.

Ministria e Drejtësisë

Lidhur me kompetencat e QKUM-së, sqarojmë se QKUM lidh marrëveshje me Spitalet (universitare, rajonale dhe bashkiake), Qendrat Shëndetësore, institucione private etj, për mbulimin e shërbimit me personel të vetin ose të Institucioneve të sipërpërmendura.

Është bërë riorganizimi i sektorëve brenda drejtorive përkatëse, si hallka të domosdoshme të proceseve të punës së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur parimisht dakord.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.933, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar”

Departamenti i Administratës Publike

Departamenti ka bërë disa sugjerime në funksion të përmirësimit të cilësisë së projektaktit. Të gjitha sugjerimet janë marë në konsideratë dhe është marë dakordësia nga DAP me email.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, urgjencat paraspitalore të tre spitaleve universitare (SUT, SHUSHN, QSUT), riorganizohen në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Financimi i QKUM-së do të jetë në përputhje me ligjin e buxhetit për vitin 2020.

Organika aktuale

FUNKSIONI (SIPAS STRUKTURËS)	Nr. punonjëse	Klasa / Kategoria	Paga e Grupit/Paga baze	Vjet. vite	Vjet. ne leke	Paga per Pozicion	Niveli I shteses per kushte pune	Shtesa per pune me turne	Shtesa page te rregulluara me ligje te vecanta	Total paga bruto vjetore (000/leke)	Sig shoqerore	Totali fondi I pagave dhe kontributit per sigurimet shoqerore
b	1	2	3	4	5=3*2%*4	6	8	14	22	21=20+7	23=21*16.7%	24=21+22+23
Drejt te Pergjithshem	1	II-a	14,000	10	2,800	118,600				1,625	271	1,977
Sekretar, Arkivist	2	IX	36,000	15	5,400		6,900			1,159	194	1,411
Llogaritari mesem,	1	IX	36,000	25	9,000		5,175			602	101	733
Drejtor Drejtorie	3	III-a/1	14,000	20	5,600	81,800				3,650	610	4,443
Pergjegjes Sektori	7		14,000	15	4,200	71,700				7,552	1,261	9,190
Specialisti i larte	19		14,000	15	4,200	50,500				15,664	2,616	19,063
Specialisti i larte mjek	16		14,000	15	4,200	57,000	2,000	29,100	25,000	25,210	4,210	30,680
Kryeinfermier	1		14,000	15	4,200	40,000	2,000	19,200		953	159	1,160
Infermier	25		14,000	15	4,200	38,000	2,000	18,700		23,070	3,853	28,076
Shofer	3	IV	33,400	6	2,004		5,175			1,461	244	1,778
Sanitar / Pastrues	4	I	30,000	15	4,500		6,900			1,987	332	2,418
Magaznier	1	V	34,100	25	8,525		6,900			594	99	723
Operator	1	V	34,100	15	5,115		5,175			533	89	648
Teknik mesem (spec te ndry)	2	VI	34,500	22	7,590		5,175			1,134	189	1,381
Totali	86		336,100		71,534	457,600	47,400			85,193	14,227	103,680

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.933, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar”

Organika bëhet

Paga e Grupit/Paga		Vjetërsia mesatare		Paga per Pozicion		OR i pages baze (000/leke)														
		ne vite	ne leke			Niveli i shteses per kus		e shteses p		per pune mesen per pun		per thirrjet/gulluara		mages se rreg		tesave te pagave (000/leke)				
b	1	2	3	4	5=3*2%4	6	7=(6+5+3)*2/1000	8	9=8*1000*2	14	15=14*1000*2	16	22	23/22*(1000*2)	24=11+13+15+17	21=20*7	22=21*5%	23=21*6.7%	24=21+22+23	
Drejtor Përgjithshëm	1	II-a	14,000	25	2,800	118,600	1,625	-	-	-	-	-	-	-	-	1,625	81.24	271	1,977	
Sekretar/Specialist i lartë	1		14,000	20	2,800	50,500	808	-	-	-	-	-	-	-	-	808	40.38	135	983	
Sekretar, Arkivist,	1	IX	14,000	20		50,500	774	6,900	83	-	-	-	-	-	83	857	42.84	143	1,043	
Llogaritari mesem,	1	IX	36,000	25	9,000		540	5,175	62	-	-	-	-	-	62	602	30.11	101	733	
Drejtor Drejtorie	3	II-a/1	14,000	20	5,600	81,800	3,650	-	-	-	-	-	-	-	-	3,650	182.52	610	4,443	
Përgjegjes Sektori	9		14,000	20	5,600	71,700	9,860	-	-	-	-	-	-	-	-	9,860	493.02	1,647	12,000	
Specialist i lartë	14		14,000	25	7,000	50,500	12,012	-	-	-	-	-	-	-	-	12,012	600.60	2,006	14,619	
Specialist i lartë mjek	59		14,000	25	7,000	57,000	55,224	2,000	1,416	29,100	20,603	18,000	25,000	17,700	22,019	94,943	4,747.14	15,855	115,545	
Kryeinfermier	2		14,000	15	4,200	40,000	1,397	2,000	48	19,200	461	12,000	-	-	-	509	1,906	95.28	318	2,319
Infermier	89		14,000	20	5,600	38,000	61,517	2,000	2,136	18,700	19,972	12,000	12,502	13,352	22,108	83,624	4,181.22	13,965	101,771	
Shofer	63	IV	33,400	20	6,680		30,300	5,175	3,912	-	-	10,000	-	-	-	3,912	34,213	1,710.64	5,714	41,637
Sanitar / Pastrues	5	I	30,000	15	4,500		2,070	6,900	414	-	-	0	-	-	-	414	2,484	124.20	415	3,023
Magaziner	2	V	34,100	25	8,525		1,023	6,900	166	-	-	-	-	-	-	166	1,189	59.43	198	1,447
Operator	1	V	34,100	15	5,115		471	5,175	62	-	-	-	-	-	-	62	533	26.63	89	648
Teknik mesem (spec)	2	VI	34,500	22	7,590		1,010	6,900	166	-	-	-	-	-	-	166	1,176	58.79	196	1,431
Totali	253		328,100		82,010	558,600	182,281	49,125	8,465							49,500	249,481	12,474	41,663	303,618

Kosto per Ekipin Mjekesor te angazhuar ne evente per te trete						
Mjekë						
P.Baze	Vjetërsia	P.Pozicion	K.Pune	Shtese Turne	Urgjenca	Gjithsej
14,000.00	3,500.00	57,000.00	2,000.00	29,100.00	18,000.00	123,600.00
123.600 leke/22 dite pune=5.618 leke/8 ore=702 leke ne 1 ore pune						
Infermierë						
P.Baze	Vjetërsia	P.Pozicion	K.Pune	Shtese Turne	Urgjenca	Gjithsej
14,000.00	3,500.00	38,000.00	2,000.00	18,700.00	12,000.00	88,200.00
88.200 leke /22dite pune=4.009 leke /8 ore=501 leke ne 1 ore pune						
Shoferë						
P.Baze	Vjetërsia	P.Pozicion	K.Pune	Shtese Turne	Urgjenca	Gjithsej
33,400.00	5,000.00		5,175.00		10,000.00	53,575.00
53575 leke/22 dite pune=2.435 leke/8 ore=304 leke per 1 ore pune						
Kosto per nje ore pune per gjithe ekipin Mjeko/Infermier/Shofer						
702+501+304=1507 leke per 1 ore pune per 1 ekip						
1.507 leke Ekipi per 1 ore						
per 1 dite pune 24 ore = 36.168 leke ne dite						
Dieta Ditore		5500 lek per cdo punonjes				
1 ekip		16.500	ne dite			
Kosto per 1 dite pune 24 ore		kosto /1 ore				
Paga	36,168.00	1,507.00				
Dieta	16,500.00	687.50				
Mirembajtje Autoambulance +Paisje	4,032.00	168.00				
Shpenzime karburanti 1 dite	6,800.00	6,800.00				
Te tjera	1,000.00	41.67				
Kosto Gjithsej	64,500.00	9,204.17				

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.933, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar”

Kosto per Trajnim

Trajnime							
Salla	Trajneret	Shpenzime Energji/Uje/Internet	Mirembajtje Ambjentesh	Kancelari/Pastrim /te tjera	Amortizim Godines/Sal la	Certifi kimi	Gjithsej
	9,400.00	1,946.00	822.00	200.00	2,489.00		14,857.0 0

24.835 leke ne dite /24 ore= 1035 leke per 1 ore trajnim

Mjeke	123,600.00						
	0	5,618.00					
Infermiere	83,200.00	3,782.00					
Energji	350000 leke ne muaj/30 /21*3)zyra salla e trajnimit= 1667 leke						
Uje	14000/30/						
	8*2=	117					
Internet	34000/30/21*3=162						
Mirembajtje Ambjentesh	2.100.000 leke/365dite=5753/21zyra*3 zyra =822 leke ne dite						
Amortizimi godines	ne vitin 2019 6359958 /365 dite/21 zyra*3=2489						
	5						
Mjeke	,618.00						
Infermiere	3,782.00						
Shpenzime te tjera	5,457.00						
Gjithsej	14,857.00	ne dite/8 ore=1857.12 leke/ore					

Strukturat e reja që krijohen janë brenda numrit të punonjësve për QKUM dhe urgjencën mjekësore paraspitalore të Tiranës që riorganizohen, të miratuar për vitin 2021.

Punonjësit ekzistues do të risistemohen në strukturën e re.

1.Efekt financiar nga kalimi i personelit te urgjences paraspitalore nga Spitalet Universitare Tirane (3 spitale) tek QKUM

2.Efekt Financiar nga kalimi ne sherbim te urgjences mjekesore paraspitalore te personelit te Njesise se Koordinimit te Urgjencave Mjekesore

(Mjeke, Infermiere, shofere)- ku perfitojne shtesa per natyre te vecante pune , (Per sherbimin e urgjences, Mjeke 18.000 leke , Infermiere 12.000 leke dhe shofere 10.000 leke (sipas VKM nr 188.dt 15.03.2017pika 3/h/12/5

3.Efekt financiar per trajnimet nga shtesa e numrit te punonjesve (mjeke infermiere) sipas vkm 911 ,dt 21.12.2016

Efektet financiare për vitin 2021, do të përballohen nga buxheti i shtetit zëri “shpenzime për paga”, art.600 të miratuara për MSHMS për vitin 2021.

Pra, ky projektvendim ka efektet financiare të mësipërme në buxhetin e shtetit, të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2021.

PROPOZUESI

MINISTRI

Ogerta Manastirliu